

814 - 1

B. 92

XHAHIL BILBILI

PER NJOFTIM
E
PER VEPRIM

20

60-364

NDJERM ARRJA SHETËRORE E BOTIMEVE
156-166 TIRANË 1955

891-983 - 1

~~149.00~~

525

B - 9 2

XHAHIL BILBILI

11 544

8A1
Bil 56

BIBLIOTERA E GJYKONJ
GJYKONJ

PËR NJOFTIM
E
PËR VEPRIM

NDËRMARRJA SHITËTORE E BOTIMEVE
TIRANË 1955

Tirazh : 3000

Stazhi 2204 - 52

Stabilimenti «Mihal Duri» — Tiranë

PATRIOTËT

Ish ato dit' kur Peza kishte ftuar
shqiptarët më të mirë në Kuvënd
që t'i bashkonte, jo për të lëftuar
me kukurece, po me gjithë mënd:
me pushkë që bën bam edhe tymos,
e jo me brilantinë e Kolynos. . .

E kur atje kërciste e bubullinte
dhe flaka merrte dheun, në Tiranë
paria kombëtare hingëllinte
«për Shqipëri!» në grazhdet veteranë,
ku hante e s'ngopej, shtruar këmbë-kryq,
tagjin që i kishin vënë disa miq. . .

* * * * *

Ish ato dit' që i pashë ata të tre
duke pirë raki për mëmëdhe. . .

Çdo mbrëmje shkonin n'atë pijetore.
Ishin: një tregëtar i përaruar,
një funksionar me një bastun prej dore
— shënjë se rroga ecte e pandryshuar —
edhe i treti në seri një tjetër
q'ë hiqte vehten patriot i vjetër. . .

Ata miq kishin qerë kurdoherë,
po tani von i bashkoi fort bardhaku
që thithnin në një qoshe dim'r e verë,
sepse i brente shumë ay merak:
si do t'i bëhet halli Shqipërisë
që ra në duart e fëmijërisë. . .

Të tretin e thërrisnin patrioti. . .
Jo vetëm se nga mosha ish i shkuar.
po se ish një ng'ata që kur baroti
për mëmëdhe buçiste në krahuar,
ay, me sa tregonte, edhe kur flinte
vetëm atdheun' e dashur ëndërrinte. . .

Prandaj i bënin nder edhe e çmonin
këtë ushtar të vjetër t'Idealit,
mbasi, në fund të fundit, po mendonin
se çunave që kishin dalë malit
vetëm ky patriot me ca të tjerë
mund t'ua hante kokën menjëherë. . .

Dhe patrioti nuk përtonte fare
së foluri për ngjarjet kombëtare. . .

U fliste për Naimin, po pa shtuar
se e urrente që s'ish turçeli. . .
Fliste me zjarr për shqipen e bekuar,
sado që fliste turçe në shtëpi,
edhe, pasi shpëlodheshe një grimë
n'ato kujtime me një psherëtimë,

u thoshte për Çerçizin nonjë fjalë. . .
për Mashkulloren. . . edhe për Njëzetën. . .
po për vehte nuk thoshte asnjë fjalë:
si e ku kish lëftuar për kuletën;
as për një shënjë plage mbi lëkurë,
që kish në mes të ballit, s'fliste kurrë. . .

Po pikërisht kjo plagë mu në ballë
— që kish formën e plagës kombëtare —
të tjerve ua bënte mëndjen dhallë. . .
Prandaj ata të dy s'dyshonin fare
se ajo shënjë atje ish dokument
i një patriotizmi permanent. . .

* * * * *

Nuk ishte vetëm ky. Edhe të tjerë
i qenë bërë Shqipëris kurban
dhe e hiqnin vehten patriot me vlerë
vetëm me shënjën q'u kish lënë. . . një çiban!

O X H A Q E T

— Ju s'latë gjë, na thonë, pa sheshuar!
Të gjith' oxhaqet që kish ngritur moti
i tretët si këlqeren e pashuar. . .
U tret, tok me oxhakun, dhe i zoti! —

Kush tha se e lamë vëndin pa oxhaqe?
Tek ne s'del tym Sarajesh e Pallatesh,
se ngrihen gjer në qiell, si bajraqe,
oxhaqe kombinateh!

FILXHANI I KAFESË

E shoh shpesh herë ish beun, zëmër-thyer,
me shpirtin majë dhëmbëve mbërthyer,
akoma me një shpresë,
kur po zvarriset mbrëmjeve, i dërmuar,
në një rrugicë t'heshtur, t'errësuar,
dhe trokëllin te der' e Nadiresë.

Një shpres' e ballsamësor
për luftën e flamosur
që ndjellka plot peshqeshë,
kërkon ilaç e ngushëllim
n'ato që thotë plot kuptim
filxhani i kafesë...

- Sytë më shohin korb mavri
që fluturon pa krye...
Qamet, o bej, për perëndi! —
- U bëftë botë varr i zi,
se ky qamet ka kaqë vjet
që m'a mban shpirtin me gajret! —
- Një gjë të zezë shoh tani:
tamam si thes i fryrë
mbi një qefin të shtrirë...
Thesi është mall e mehmuriet,
po ky qefin... — Folë, moj, ç'pret!

- Është qefin' i harbutëris? —
 — Qefin filxhani mollois,
 që e ka udhën për qivur...
 Diç shoh të shkruar... ja: një gur...
 një varr... një djall q'e ruan...
 — Ç'farë, moj shtrigë, shkruan? —
 — KËTU, thotë e shkruara,
 PO... DERGJET... E... KALUARA!

HANKO HANËMI

Në mbrëmje, pran' oxhakut, mbi minder,
 hedhur në sup një shall, këmbët mbuluar,
 tretur në faqet kockë, sikur s'merr
 frymë nga gjoksi-drras' e jetëshuar.

Gjishtrinjt' e tharë shkundin rrallë-rrallë
 në prush t'oxhakut hirin e duhanit,
 dhe syt' e saj të tretur, si në prallë,
 sjellin ndërmënd kujtimet e zamanit.

Syr' i dremitur, nonjëherë, i bie
 mbi një kuadër varur lart në mur,
 dhe i bëhet Xhemil Beu si një hie
 shtrirë me salltanet në një qivur.

Një ankth e mbyt Hanëmin atëhere
 dhe, si padashur, buz' e saj e ngrirë
 zë e lëvis, si n'atë koh'n e mirë,
 kur kish akoma bletë në koshere
 q'e burbuletin mbretëreshën shtrirë.

Në dejt e ngrirë i duket, papandehur,
sikur një afsh rinie ja ndez gjakun,
kur i kujtohet sesi shkiste fshehur
dhe si ja merrte Xhemil Beut hakun
me qehajà Alinë — shpuz' e ngjalë! —
që i bëri Ym' r oxhakut me një djalë.

Një dritë e kuqërreme e ndriti odanë,
kur prushi u skuq nga një rënkim trishtimi,
dhe u shua përsëri. Vetëm kujtimi,
p'r ato që s'kthehen më po ik'n e vanë,
s'iu shua bejlereshës. Në oxhak
prushi u bë hi dhe vatra s'nxjerr më flakë!

MERIMANGA E VJETËR

Zhaneta s'i ka mbushur të njëzetat.

Me gjith'atë, mamaja, shpesh, i thotë:

- T'ish dje, ma sher, që i kishim plot kuletat,
nuk do kërkonim dhëndër nëpër botë.

Po sot e sheh... Mbetëm me gjisht në gojë... —

Edhe vazhden mamaja t'a sqarojë:

- Prandaj, moj shpirt, mendohu që sivjet
të gjesh një bashkëshort, se koha s'pret.

Të rinj ka plot... dhe intelektualë!

Pastaj dëgjo, moj bijë, dhe një fjalë:

ti sigurohesh mirë e, veç kësaj,

edhe familja jonë më pastaj

do të shikohet mirë gjithëmonë;

se dhëndrin do t'a kemi si kollonë...

.....

Aksioni i Zhanetës ka filluar.
Me takt e djallëzi të rafinuar
— kur kandidati e thyen trimërisht
sulmin që po i bëhet frontalisht —
ajo njihet me motra e kushërira
që të përhapin fjalët më të mira:
— T'a dish ti, mor Petrit, se sa xhentile!
E dashur, nuk di spica e fitile.
Ajo sikur nuk është rritur fare
në rrethin e një shtrese tregëtare...

.....

* * * * *

Të rinjtë tanë sot janë Petritat
që din' e ruhen mirë nëpër pritak
ku Merimanga e Vjetër, nëpër hie,
thurr rjeta dashurie.

Po gjen posht' e përppjet' e nonjë tjetër
kjo Merimang' e Vjetër;
e gudulis me naze e me ruzhe
e me të kuqe buze,
dhe nuk sheh dot se ç'fshihet nën rrogos...
Po forma, pa përmbajtje, s'vlen një grosh!

PËRPARIMTARIT FANATIK

(epigram)

Fëmrat e botës do t'i admirosh
me syt' e tu sqifterë...
Po gruan s'të vjen mirë t'a zbulosh;
t'a nxjerrsh, demek, pa përce një cop' herë.

Të renë, për të cilën pretendon
se ti përpiqesh, flet e predikon,
mu në shtëpi e ke; q'andej filloje:
zbuloje, de, zbuloje...

MËNDJEMADHIT

(epigram)

Të tha kush mëndjemath? Ay gënjen!
Për mua, gjer sa mëndja të pëlqen
kaqë e kaqë shumë,
ti je në hall, se s'paske hiç, o lumë!

BUROKRATIT

(epitaf)

Si t'u tha goj' e shkretë sot?
Ç'pësove këtë herë?
Pse Shën Mëhillit s'ja dhe dot,
sapo e pe në derë,
atë xhevap të shkretë:
— Tani s'kam kohë! Nesër,
nga ora njëmbëdhjetë!...

NJË POETI

(epigram)

Ç'ecën kështu me çantën në një dorë?
Ç'ma mban në kokë gjith'atë kurorë
që e ke thurrur vetë?
Hiqe! Dhe prit, i qetë,
që të t'a thurrin njerzit, gjithë ndere,
pas masës, me dafinat sërë-sërë...
Po kokën mos e fryj as atëhere,
sepse kurora nuk do të të nxërë!

AKRABALLËKU

Një ditë, ka ca kohë, veshi im
dëgjoi rastësisht një bisedim
që bënin dy, Filani dhe Fëstëku,
për pun' akraballëku:

- Hë, si të bënja? Nja një vit përpara,
kur e pushuan, mbeti keq, pa punë.
Ç'të bëj? Sado që kish mjaft të palara,
e mora në ndërmarrjen ku jam unë.
Kunat, mendova, e kam, nuk do t'a shkelë!
Tani, kujdes, i thashë, mor Xhavit!
Me gjith' atë ay vazhdoi të vjelë,
edhe tani më del me deficit...
- Duhet t'a denoncosh! Ka bërë faj!
- Ka bërë faj, po un' e kam kunat.
S'është kollaj...
E kam vëllan' e gruas, taksirat!

- Gabim! Në punë s'ka farefisllëke!
Ti, si drejtor që je, nuk ka lezet
t'a shkelsh detyrën për akraballëke!
Këtu s'je bashkëshort, po je pushtet!
- Vallaj, do t'ja mbuloj...
Po ti bëju memec, mos e bëj fjalë...
se kush e di... Gjer sa t'ja rregulloj...
Ç'të bëj, o byrazer... U bëra ngjalë...
- Jo, mor vëlla! Fjal' është ajo që thua?
Hiç mos u bëj merak... Ç'më duhet mua!

* * * * *

Nuk di sesi vijoi ky muhabet.
Drejtori u bë ngjalë, zu të shkasë,
kurse «memeci», e sheh se po rrëshqet,
po «s'mund» të flasë...
Shokë! Sot nuk jetohe duke shkarë,
sepse për ngjalët... ka dhe peshkatarë!

KAMELEONI

Një nëpunës — iu rritt' ndera! —
paska një specialitet:
e kthen gunën nga fryn era
fët e fët, po me lezet!

E ka mirë me portjerin;
shumë mirë me korierin;
mjalt' e qumësht me drejtorin;
bakllavà me inspektorin!

Nuk merr kurrë një qëndrim.
Thellë, kot, kurrë nuk futet.
Dhe kur shpreh nonjë mendim,
heq, po jo sa të këputet!

Nëpër mbledhje, kur kritika
kap Filanin dhe e shkund,
ay s'luan nga karika.
Nuk nxitohet. Flet në fund...

Pret, njëherë, të shikojë
se nga do anojë pesha,
dhe pastaj fillon të shtojë:
«edhe unë, shokë, desha»;
edhe heth, jo më të kotë,
pro shumicës dhe një votë.

Dhe Kameleonin kurrë
s'do t'a shoç me një fytyrë.
Pasqyron përmbi lëkurë,
sipas rastit, atë ngjyrë
që kan' bimët rreth e qark...

* * * * *

Forca, shokë! Kritikoni!
Le të dridhet Kameleoni
kur kritikën, nga çdo anë,
do të fryjnë si murlanë!
Guna, ahëre, s'do t'i vlejë,
se s'do dijë nga t'a kthejë...

VASILI

Shoku Vasil!
Ti je servil!
Edhe kjo sjellje s'të ka fare hie!
Me peqe e lqpe do t'a kalosh jetën?
Duhet edhe një fije burrërie,
jo laj e lyej vazhdimisht, të shkretën!... —

Vasili, me përgjigjen mu në gojë,
filloi, si artist, të recitojë:
Unë, shok kryetar, ju falnderoj!
Sjelljen që po tregoni sot me mua,
singeritetin, kurrë s'i harroj!
Një superior si ju — s'di si të them! —
as e kam patur kurr' as do t'a kem...
As unë një inferior, shoku Vasil,
kaqë servil!

ASLLANI

Gjat mbledhjes, kur u shtrua se ca shokë
nuk kritikojnë, s'bëjnë diskutime,
Asllanit i vërtitëshin në kokë
disa mendime:

«Të vegjëleve, për çdo gabim në punë,
ua përplas kritikën trimërisht.
Po për këdo që rri më lart se unë,
ç'më duhet? I bëj bisht...
Drejtori ka të meta... Un' e di!
Duhet nga kolektivi kritikuar...»

Dakord! Po le t'ja ngren' atë padi
të tjerë, më të zgjuar...
Ç'më duhet mua? Po sikur, për dreq,
t'a prekë ajo kritikë?
Nxehet edhe më merr me sy të keq.
Vallaj, s'ma mban... Kam frikë...
Të tjerët s'trëmben. Ekstra! S'ke ç'u thua!
Ç'u ndodhi? Hiçgjëkafshë gjer më sot!
Po kush më siguron se s'më ndodh mua
nesër, o për një mot?»

* * * * *

Ç'ke, o Asllan, që dridhesh? Paske frikë
t'i bësh tjetrit kritikë?
Or ti je lepur! Sot nuk ecet dot
«me urt' e butë dhe tigani plot!»

ALISHVERISHI

Në disa dyqane
shitsat, shok me shok,
me mallin e shtetit
bëjnë reciprok.

Një jep stofë dhe merr pjata;
një jep pjatë dhe merr mish;
një jep uthull, merr sallata...
De, or, de, ç'alishverish!

Lidhjet, dalngadalë,
bëhen familjare,
se kush ka një djalë
ka edhe kumbare.

Pa merr motra dhe mamaja...
një kunat, një kushëri...
Pa merr tetua, pa merr daja,
krushq e krushka... mizëri!

Dhe kur gjith' akraballëku
luan dhëmbët, vjen një ditë
që Filani e Fëstëku
furnizojnë dhe komshitë...

- Po mos jesh në tarikat,
të përgjigjet gjith'inat:
- S'ka! Nuk ka! Na u mbarua! —
Dhe po i fole pak më gjatë:
 - Po ç'kërkon, mor shok, nga mua?
Un'i shes, e... s'kam një pjatë! —
 - Shoku shitës! Dale, prit!
Këto, mua, mos m'i shit!

MBYTËSI I KRITIKËS

Presidiumi zuri vënd në sallë.
E heshtur del dhe fryma nga krahrori,
kur ja, fytyrë-mvrejtur dhe me pallë,
ngrihet drejtori:

- Kjo mbledhje, shokë, s'është si të parat!
Nder' i ndërmarrjes sonë është prekur!

Dikush kujtoi se nxier të palarat
dhe i dërgoi shtypit një kritikë.
Më kot është përpjekur!
S'kam frikë!
Ku është dishiplina e pushtetit?
Si shkroi pa e parë udhëheqja?
Ay dekonspiroi sekret të shtetit,
po nuk mendoi — dhe kjo është m'e keqja —
se kush vepron kështu futet në kllapa...
Dardha e ka bishin prana!
Prandaj, sot, s'mund të fshihet nëpër vëra.
Të ngrihet e të thotë: «un' e bëra!»

— Po, un' e bëra! — u ndie një zë në sallë —
Qëndroi n'ato që shkrova në gazetë!
Nuk trëmbem ng'asnjë pallë!
Ç'kam për të thën' e them, pa frikë, vetë! —

Drejtori, atëhere, i lënduar,
u nxeh, bëri një giest të egërsuar,
edhe buçiti i tmerrshëm si stuhija:
— Ku e more atë kuxim...

— M'a dha Partia!

PËR NJOFTIM E PËR VEPRIM

N'ato zyra shtetërore
ku ka fjal' e shumë bujë,
mbyten njerzit si vapore
brënda në një gotë ujë.

Gjegj' e parë që të japin
është: — Shok! M'a bëj me shkresë! —
Pastaj ti rri prit xhevapin,
rro me shpresë...

Vet' e vjen korespondenca
«për njoftim e për veprim»,
dhe ngatërrohet kompetenca:
ja dërguan Nëlëaut;
ja përcelli Nëshëaut;
ky ja nisi Nëshëait,
Nëshëai Nëtëlait...

- Po aman, mor shok, se plasa!
Ç'të kërkova? Tri dërrasa.
Ç'më vërtit dorë më dorë!
Kam tridhjetë punëtorë
duar-lidhur, që s'punojnë
për dërrasat që mungojnë!
- Sot nuk ndodhet, shok, prezent,
as drejtori, as nëndrejtori.
- Firmo ti. S'je kompetent?
- Nuk kam çelsat, se i mori,
dhe pa vulë s'firmoj dot...

* * * * *

Tri dërrasa, o burokratë,
ju kërkova e s'mi dhatë.
Burokratë! Merni masat
sepse... ju mungojnë drrasat!

RRETH E QARK

Kur puntori rreh të çpikë
nonjë mjet, që akësh punë
t'a mbarojë sa më parë,
Burokrati — në karikë
që të Hënën gjer të Shtunë —
rreh sesi t'a heqë zvarrë...

* * * * *

- «Eja nesër...» kam dëgjuar.
«Jam i zënë...» e kam provuar.
«Do shqyrtohet...» e kam ditur,
po pardje më ka çuditur
një përcjellj' e re, me art:
— Shko më lart!
— Pse më lart, shok referent?
— Është shefi kompetent! —
Shefi, plot... përgjegjësi,
më dërgoi në kryesi...
Dhe kryetari,
q'është'i pari
e shikoka shumë lark,
m'u përgjegj: — S'më takon mua!
Ndiqe çështjen, shok, në Qark! —

Shkallë-shkallë se ç'u ngjita!
Rreth e Qark se ç'u vërtita!

Hyr' e dil nga një cop'herë,
dhe në Qark, derë më derë,
më në fund di se ç'më thanë?
— Ndiqe lart, shok, në Tiranë...

* * * * *

Un' e ndoqa, siç më thatë,
punën time, o burokratë!
Po dhe tuajën, demek,
këmba-këmbës do t'a ndjek!

MALLI I SHTETIT DHE MALLI IM

I

Në një ndërmarrje — emrin nuk ja them,
që, kujt t'i djegë fort, të mund të kruhet —
drejtori na ka gjetur një melhem
t'a bëjë punën t'ec'ashtu si duhet.

Jo se s'gabojnë njerëzit. Aspak!
Gabojnë, po melhemi i drejtorit
i vë çështjes kapak
dhe s'hiqet kurr' asnjë pet' e lakrorit!

- Sa dolle deficit, more katran?
- Dymijë lek... Nga pastat... Di dhe unë?
- T'i ballancosh nga pijet, pa derman:
ca gram raki më pak... dhe mbaron punë.
S'dua të të bëj keq,
se ke fëmijë, grua, prindër pleq! —

Leku pjell lekun. Dhe kështu hajduti
nxier nga arka e shtetit mijra zocëka,
sepse drejtori, i ndjeshmi dhe i buti,
po ja mbulon si kllocëka!

II

Po ky drejtor, kur shkon e blen cigare
dhe shitsi i jep kusur nonjë lek metë,
deficitin e tij s'e mbulon fare
edhe e mbron me gjoks arkën e vetë:
— «Me mall të shtetit do të bësh përshesh?
Po unë s'jam sylesh!» —
Dhe shkon më lart për të senjalizuar...
Ç'ndërgjegje e kulluar!

VIGJILENCA E KALEM KARAFILIT

Kalemi nuk e nxjerr sekretin jashtë,
se fjala është fëmër edhe lint...
Edhe Fëstëkut, q'e ka mik të lashtë,
s'i thot' as një për qint...

Po qint për qint, me fakte e me tapi
— vulosur siç e ka me dyll në krye —
çdo gjë q'është sekrete, ay e shpie,
të siguruar, drejt e në shtëpi.

Çdo dit' i sjell një lajm të freskët, taze...
Po nuk mendon, i shtrënjti Karafil,
se gruaja, me tarranà e saze,
do t'ja këndojë lagjes si bilbil!

Kështu, pardje, Kalemit s'ju durua,
edhe raport'i tij u kulmërua:

- Lere, i tha së shoqes, se ç'po ngjet!
Pas kaqë vigjilence, dje, papritur,
zbulova më në fund kush e kish qitur
jashtë atë sekret
që fliste, rreth kuadrit, për shkurtime
në drejtorinë time...

.....

Kalemi Karafil mbron teorinë

- që bashkëshortët shum' a pak e dinë —
se burri i sjellshëm, gruas, s'ka lezet
t'i mbaj' asnjë sekret.
Sepse, me domosdo,
duhet t'i japë prova se e do...

* * * * *

E sheh, o Karafil, si të marr' erë?
Unë nuhat, ruk jam si ca të tjerë...

VITI i RI

Natë Dhjetori. Terr. Dritaret duken
si mijra sy që pranë-pranë struken,
se kush t'a shoh' i pari, n'errësirë,
Vitin e Ri që vjen si djal' i mirë.

Dhe kur kudo ndërpritet muhabeti
e drita q'u ndes rishtas ngjall gëzimin,
diku, atje ku sheh vetëm poeti,
i Vjetri i bën të riut dorëzimin.

Parakalojnë, në proces-verbale,
fabrika, kombinatë, hidrocentrale;
kombajnë, nëpër ara, dhe traktorë;
qindëra shkolla maleve me dborë;
trima që çajnë malet dhe ndërtojnë;
të tjerë, në kufi, që vigjilojnë;
një popull që s'gëllitet si dikur
nga ujë, si byrek,
po u qëndron si mur
me kazm' edhe dyfek!

.....

Pastaj Viti i Vjetër, nga një thes,
nxori ca evidenca me kritika.

- I mora, tha, për ty, në çastin q'ika...
- Shpjegomë, u gjegj i riu, të marr vesh,
se këjo dosje duket mjaft e fryrë,
dhe unë jam i ri te këjo detyrë...
- Mos! — thirri Plaku — Do t'u hapësh sytë
ca ngjalave që shkasin: «Po ç'ne unë?
Unë, shok, jam i ri në këtë punë!»
Vuria veshin mirë fjalës sime.
Disa, që thua, marrin angazhime
vetëm që t'u dal' emri në gazetë.
Pastaj, kur bie ora dymbëdhjetë,
heqin me marifet përgjegjësinë,
dhe vënë në vitrinë
kushte, rrethana, plot senjalizime,
një thes justifikime
e, me një gusto fort kualitative,
një garniturë shkaqesh objektive! —

- Mirë, po kur fillon e rreh kritika?
- Pranojnë, bëjnë dhjet' autokritika,
sa për të hedhur lumin, dhe, pastaj,
kur deti bëhet vaj,
harrojnë se ç'u tha tri dit' përpara
dhe nisin nga e para...
- Ke gjë për ca që quhen burokratë?
- Çirren se i shkriu puna dit' e natë...
Përgjegjësi përsipër s'marrin dot...
Popullin nuk e presin kurrë sot...
Mbyten në një got' ujë fët e fët...
Çdolloj inisjative e kanë zët...
dhe, më në fund, kur puna bëhet llumë,
«nuk mund të jap, përgjigjen, shok, më shumë!»

.....

- Udhën e mbarë, Plak, udhën e mbarë!
Mësimet që kam marrë,
do t'i kem para syve si pasqyrë;
sado që... jam i ri te kjo detyrë!

SHKËLQIMI DHE STOLIA

Shkëlqimi dhe Stolia, burr' e grua,
kanë një djalë lum' edhe përrua.
Pse shan? Se dëgjon babin edhe mamin
që, kur e hapin gojën pa kapak
dhe shahen me shojshoq sa lënë namin,
e edukojnë djalin për merak...

- Mblidhe, o Shkëlqim, i thonë, s'e ke mirë!
Na u bë djall me brirë!
- Po pse e çoj në shkollë, ore, qesim?
- Është detyra jote, mcr Shkëlqim.
- Detyra ime është t'a ushqej,
e, po më ra në qafë, t'a mbërthej
e t'ja bëj kockat brumë!
Sjellja i takon shkollës, që di shumë...
T'a msoj' ajo, në klasë,
të sillet e të flasë!

* * * * *

Kur prindërit shkëlqejnë si stolira,
dhe shëmbëllat i japin fort të mira!

P Ë R K Ë D H E L J E T

Kjo edukat' e shtrëmbër e mamas
mbriti në kulm tamam dje në mëngjes
kur unë, si baba, zura t'i flas.
M'u hoth, në syt' e djalit, si këndes:

- Mjaft me këto këshilla! M'a çkallove!
Të lutem, mos i folë më! Dëgjove? —
Dhe që të më pëlcasë,
filloi t'a përkëdhelë e t'i flasë:
- Xhan' i mamasë... Mos qaj, shpirt, mos qaj...
Babi është shumë' i lik... Po ti ke mua...
Ay të qorton kot... S'ke bërë faj... —
Djali, q'u ëmbëlsua,
pushoi së qari edhe më shikoi
me një vështrim që mua më pikoi.

- Jo, s'dua, hë! Ç'ke ti kur do mësoj?
- Flas për të mirën tënde, more djalë.
Të them që të mësosh, të këshilloj. . .
- S'më do, prandaj m'i thua këto fjalë!
- Po si, mor bir, i thirra, s'ke nevojë
për fjalët e tyt et që të ka rritur? —
E pat. Filloi të qajë duke britur. . .
Ajo e mori pranë që t'a mbrojë. . .
edhe kështu, nga vrull'i ktij tërmeti,
më ra cop' e thërrim' autoriteti.

* * *

Të tjerët kanë vetëm një mendim:
si t'i bëjnë fëmijët xhevahirë.
Unë, për fatin tim,
kam edhe gruan që do gdhëndur mirë.

Po s'epem! Do lëftoj deri në fund!
Për hir të djalit, gruan do t'a mund!

N Ë G J Y Q

- Si t'thonë? — Ram Sahati — Vjeç? — Shtatdhetë.
- Fëmij' a ke? — I kam nja katër cuca.
- Ket ktu ç'e ke? — Vallahi, gruen e tretë,
po tash sa koh' po m'qitka do hardhuca
qi, pasha nderin, ba me t'folë ma gjanë,
as dreqi, si i patën thanë,
s'kish mujtun me e durue
në shpi të vet për grue. . .
- A thue, bre burr', tash von t'ka qit hardhucat,

- a shum' vjet para, heret,
dhe s'mujtke me u pajtue...
- Vallahi, për mue, një gja vet kam kuptue:
s'na pugen... karakteret!
 - Kush t'tha me folë kshtu, o Ram Sahati?
 - Qe... besa... advokati!

L A M J A

Lamja e rreh të shogen dit' e natë.
S'ka ditë të mos bëjë pak shamatë
dhe, me sa kam formuar opinionin,
kohën e fundit po ja shton raciezin.

- Miqtë ja kanë thënë shumë herë:
- E ke të urtë, o Lame, xhevahir.
Prit, mos e ndaj! Mendohu një cop' herë...
 - Ore, me gruan s'riohet me pahir!
Kaq' e kam marrë zët,
që, bota të përmbysset, s'e mbaj dot!
S'luaj një qime, fët!
Le t'ikë nga shtëpia, ja: që sot! —

Ka nonjë vit që Lamja s'do t'ja dijë
për grua e për fëmijë,
sepse, siç vërtetojnë disa lajme,
pula e botës duket më e majme.

Dhe çdo mëngjes, kur niset për në zyrë
ku ndodhet edhe lulja manushaqe,
krekeset nga një çikë në pasqyrë
dhe syt' i bëjnë sikur sheh dy faqe

si moll' e kuqërreme,
edhe dy buzë-gjak që diç i thonë:
— Ndaje! Mos u trondit nga thashetheme!
Eja të rrojmë tok për gjithëmonë! —
Po kur, aty, i vijnë habit pranë
dy vogëlushë si dy lule mali
e bëlbëzojnë: — Pse e lef mamanë?
Ti nuk na cjel më koko nga paxali... —
dhe qajnë që të dy me ngashërime,
Lamja fillon të zhytet në mendime.
Por sa të hedhë prakun e shtëpisë,
mendimet i merr era e dashurisë...

* * * * *

Si të bën zëmra, o Lame, pa më thuaj,
t'i shpiesh kokot në shtëpi të huaj?